



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 1 Mars 2022

Nr: 113

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË AMBASADËS SË FRANCËS, POLONISË,
SLLOVENISË, KROACISË, SPANJËS DHE GJERMANISË PËR VËZHGIMIN E
ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot, më datë 1.3.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesën e:

KËRKUES:

1. Ambasada e Francës, me seli në Tiranë, Rruga “Skënderbej” dhe përfaqësuese zj. Elisabeth Barsacq;
2. Ambasada e Polonisë, me seli në Tiranë, “Rruga e Durrësit” dhe përfaqësuese zj. Monika Zuchniak-Pazdan;
3. Ambasada e Sllovenisë, me seli në Tiranë, Rruga “Abdyl Frashëri” dhe përfaqësues z. Peter Japelj;
4. Ambasada e Kroacisë, me seli në Tiranë, Rruga “Gjenerala Nikols” dhe përfaqësues z. Zlatko Kramarić;
5. Ambasada e Spanjës, me seli në Tiranë, Rruga “Ismail Qemali” dhe përfaqësues z. Alvaro Renedo Zalba;
6. Ambasada e Gjermanisë, me seli në Tiranë, Rruga “Skënderbej” dhe përfaqësues z. Peter Zingraf;

OBJEKTI:

Kërkohet akreditimi si vëzhgues afatshkurtër dhe përkthyes për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

BAZA LIGJORE:

Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat



e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”

VËREN:

Ambasada e Francës i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 7 (shtatë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 5 (pesë) përkthyesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Francës është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada e Polonisë i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 1 (një) vëzhguesi afatshkurtër si dhe zonën e vëzhgimit. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Polonisë është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada e Sllovenisë i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 1 (një) vëzhguesi afatshkurtër si dhe zonën e vëzhgimit. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Sllovenisë është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada e Kroacisë i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyesi si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Kroacisë është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada e Spanjës i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 1 (një) vëzhguesi afatshkurtër si dhe zonën e vëzhgimit. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Spanjës është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.

Ambasada e Gjermanisë i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër dhe 3 (tre) përkthyesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Ambasada e Gjermanisë është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor

PËR KËTO ARSYE:

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 2, datë 2.2.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër dhe përkthyes për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 7 (shtatë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 5 (pesë) përkthyesve të Ambasadës së Francës , sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 1 (një) vëzhguesi afatshkurtër të Ambasadës së Polonisë, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 1 (një) vëzhguesi afatshkurtër të Ambasadës së Sllovenisë, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër dhe përkthyes për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyesi të Ambasadës së Kroacisë, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 1 (një) vëzhguesi afatshkurtër të Ambasadës së Spanjës, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Akreditimin si vëzhgues afatshkurtër dhe përkthyes për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër dhe 3 (tre) përkthyesve të Ambasadës së Gjermanisë, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

